

## KONTRATË SHITJE KUOTE

Në Vlorë, sot në datë 27.11.2020 (dymijë e njëzetë), paiët kontraktuese nënshkruan këtë Kontratë Shitje Kuote:

**Shitësi : Alketa Kadiu**, shtetase shqiptare, lindur më 03.07.1981 në Vlorë dhe banuese në Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal I15703207K, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

dhe

**Blerësi : Ferida Leli**, shtetase shqiptare, lindur më 17.12.1997 në Vlorë dhe banuese në Vlorë, identifikuar me ID me nr. personal J76217078C, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Shitësi dhe Blerësi referuar të dy së bashku do të quhen "Palët".

### **Të përgjithshme**

1. Shitësi zotëron 1 kuotë, që përbën 100% të kapitalit themeltar, me vlerë nominale 100 000 (njëqind mijë) lekë në shoqërinë "ONE TV VLORA" sh.p.k, identifikuar me NUIS K57107201S dhe seli në adresën: Lgj. "Rilindja", Rr. "Transballkanike", Vlorë.
2. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit kuotën dhe Blerësi dëshiron të blejë 100% të pjesëmarrjes së Shitësit në shoqëri. Pas shitjes së kuotës, Shitësi largohet nga shoqëria, ndërsa Blerësi bëhet ortak i vetëm i shoqërisë.
3. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, hartohet kjo Kontratë e Shitjes së Kuotës si më poshtë:

## **Neni 1**

### **Objekti**

**1.1** Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë, Shitësi i transferon nëpërmjet shitblerjes 1 kuotë që zotëron në shoqëri dhe Blerësi bëhet ortak i vetëm i shoqërisë me 100% të pjesëmarrjes.

## **Neni 2**

### **Çmimi i shitjes dhe pagesa**

- 2.1** Çmimi i shitjes është 100 000 (njëqind mijë) lekë.  
**2.2** Çmimi është paguar dhe shlyer nga Blerësi.  
**2.3** Palët nuk kanë pretendime lidhur me pagesën e çmimit.

## **Neni 3**

### **Kalimi i pronësisë**

**3.1** Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotën nga Shitësi te Blerësi do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

## **Neni 4**

### **Të ardhurat e shoqërisë**

**4.1** Palët bien dakort që Blerësi ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga cilësia e ortakut të shoqërisë.

## **Neni 5**

### **Garancitë**

Shitësi, në lidhje me kuotën që zotëron, garanton Blerësin:

- 5.1** Se është pronar i vetëm i pjesës së shitur.  
**5.2** Se shoqëria nuk është e ngarkuar me asnjë garanci pasurore dhe se kuota është e lirë nga çdo detyrim kundrejt personave të tretë.

**Neni 6**  
**Regjistrimi**

**6.1** Regjistrimi i transferimit të kuotës nga Shitësi te Blerësi në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

**Neni 7**  
**Të ndryshme**


**7.1** Kjo Kontratë rregullohet nga Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, dhe në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

**7.2** Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë, do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo Kontratë u përpilua në 3 (tre) kopje me vlerë të barabartë ligjore. Kontrata u pranua nga Palët dhe nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur.

**Shitësi**

**Alketa Kadiu**



**Blerësi**

**Ferida Ueli**

